



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborní Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 744/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Gjokë Sokoli nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate - BKD, dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.744/2021 i datës 03.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Gjokë Sokoli nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate - BKD, dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e qendrave të votimit në Komunën e Gjakovës.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 në ora 16:12, nga Gjokë Sokoli nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate - BKD, dega në Gjakovë, duke pretenduar se i janë zhdukur dhe keqpërdorur shume vota nga subjekti politik Nisma dhe te tjerat parti pasi që nuk pasur komisionar dhe as vëzhgues. Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që ti rinumëroj kutit e votimit ne qendrat votuese dhe thekson se dëshmitë e votuesve pjesërisht i kanë bashkangjitur në një listë tjetër.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.11.2021, të KQZ-së theksohet se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kalojë (të procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatë nuk kanë vota, formulari nuk procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim. Ndër të tjera është theksuar se auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të gjeturave përgatit raportin dhe QNR në bazë të raportit të auditimit i rekomandohet KQZ-së që vendvotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Andaj asnjë formular që nuk ka përputhje nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti i nënshtrohet auditimit

kështu që vendvotimi në fjalë është verifikuar dhe i njëjti nuk është rekomanduar nga QNR-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit kërkon që të rinumërohen kutitë në qendrat votuese komunën e Gjakovës. Mirëpo, pretendimet në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në cilat vendvotime janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, por vetëm i potencon disa emra të disa shkollave si dhe duke mos treguar se sa vota i mungojnë, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtruar e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa bazuar në fakte, dëshmi të qarta dhe bindëse konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit nuk ka specifikuar asnjë vendvotim, pasi që vendvotimet në të cilat zhvillohet votimi janë të përcaktuara me numra përkatës, e për te cilën pala ankuese nuk i ka potencuar edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e apelit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia Anr.744/2021 më datën 05.11.2021**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 744/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gillogjani kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Gjokë Sokoli nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate - BKD, dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.744/2021 i datës 03.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Gjokë Sokoli nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate - BKD, dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e qendrave të votimit në Komunën e Gjakovës.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 në ora 16:12, nga Gjokë Sokoli nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate - BKD, dega në Gjakovë, duke pretenduar se i janë zhdukur dhe keqpërdorur shume vota nga subjekti politik Nisma dhe te tjerat parti pasi që nuk pasur komisionar dhe as vëzhgues. Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që ti rinumëroj kutit e votimit ne qendrat votuese dhe thekson se dëshmitë e votuesve pjesërisht i kanë bashkangjitur në një listë tjetër.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.11.2021, të KQZ-së theksohet se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kalojë (të procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatë nuk kanë vota, formulari nuk procedohet si i rregullte dhe shkon në auditim. Ndër të tjera është theksuar se auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të gjeturave përgatit raportin dhe QNR në bazë të raportit të auditimit i rekomandohet KQZ-së që vendvotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Andaj asnjë formular që nuk ka përputhje nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti i nënshtrohet auditimit

kështu që vendvotimi në fjalë është verifikuar dhe i njëjti nuk është rekomanduar nga QNR-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit kërkon që të rinumërohen kutitë në qendrat votuese komunë e Gjakovës. Mirëpo, pretendimet në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në cilat vendvotime janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, por vetëm i potencon disa emra të disa shkollave si dhe duke mos treguar se sa vota i mungojnë, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtruar e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa bazuar në fakte, dëshmi të qarta dhe bindëse konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit nuk ka specifikuar asnjë vendvotim, pasi që vendvotimet në të cilat zhvillohet votimi janë të përcaktuara me numra përkatës, e për te cilën pala ankuese nuk i ka potencuar edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e apelit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.744/2021 më datën 05.11.2021**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.